

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit

Secilit njeri i nevojitet...

Mosha

Periudha zhvillimore (nga mosha 6 deri në 8 vjeçe)

Hapësira / lokacioni

Kushte shtëpie

Vlera e karakterit

Qëndrueshmëri

Koha e nevojshme për përgatitje

30 minuta

Koha e nevojshme për realizim

30 minuta

Qëllimet

Qëllimi është që fëmija ta njohë vetveten dhe të zhvillojë vetëbesim me përparimin e vet, me qëllimet e veta, me nevojat dhe dëshirat; të nxitet që t'i respektojë dallimet (gjini, përkatësi etnike, prejardhje sociale, pamje të jashtme).

Rezultatet e pritshme

Fëmija verbalisht i shpreh nevojat dhe dëshirat e veta; i numëron dhe i respekton ngjashmëritë dhe dallimet tek njerëzit.

Kahje

Përgatitje paraprake për aktivitet

Që të potencohet çfarë i nevojitet çdo njeriu në jetë, bashkërisht bëjeni një listë të punëve që mendoni se janë të domosdoshme. (Kjo është shumë efikase nëse çdo anëtar i familjes bën një listë të veçantë). Çdo anëtar bën listë e pastaj e krahason me anëtarët tjerë të familjes. Bëjuani me dije të gjithëve se duhet të kenë shpjegim pse e kanë zgjedhur artikullin përkatës të listës së tyre). Bisedoni për atë se vallë do kishte ndryshuar kjo listë nëse ata jetojnë në ndonjë shtet tjetër.

Vazhdoni me diskutim për atë se vallë duhet ose jo ndryshim në varësi të vendit të banimit ose të kulturës.

Shtypje e skemës nga shtesa ose skicim i së njëjtës (6 – 9 katrorë të zbratur).

Përgatitje e fletëve të letrës të bashkëlidhur si libër.

Instrukcione/kahje për lojën





Çdo anëtar duhet të vizatojë çfarë i nevojitet çdo njeriu në jetë. Mund t'u jepni shembull (dashuri, miq, shtëpi, ushqim, ujë, libra etj.);

Nëse bëhet libër, fëmijëve duhet t'u shpjegohet se si të bashkëlidhin më shumë faqe, të vizatojnë kopertinë, të shkruajnë titull dhe autor dhe ta shkruajnë përmbajtjen dhe ilustrime sipas dëshirës.

Aktivitet/lojë

Bisedoni për ngjashmëritë dhe dallimet tek njerëzit në botë (sipas ngjyrës së lëkurës, ngjyrës së syve, lartësisë, kulturës, zakoneve etj.). Mund të jepen shembuj për ngjashmëri dhe dallime ndërmjet anëtarëve të familjes, miqve, të njohurve e të ngjashme dhe të bisedohet për atë se si ata, po edhe njerëzit nga kultura të ndryshme kanë po të njëjtat nevoja (shtesa nr. 1 – shikojeni videon dhe bisedoni); pastaj jepen kahje për punimin e librit “Gjithkush ka nevojë/ Secilit njeri i nevojitet...”

Shembull për pyetje:

Parashtroni pyetjet në vijim: Meqë dikush është i ndryshëm, a e bën këtë gabimisht / drejt ose më mirë / më keq se ju? Pse? Duhet t'i respektojmë dallimet e ndërsjella, po si mund të dëftojë respekt...në klasë? ...në fushën e lojës?...Në shtëpi?...Me fqinj?...Me një person nga një tjetër kulturë? Si do t'kishit dashur dikush të sillet me ju?

Bisedoni me fëmijën për atë se si do ndihej poqë se shpërngulen në një vend ku nuk njohin askënd dhe nuk e flasin gjuhën e tyre. Si do ndihej nëse do t'ishte i përjashtuar? A ka frikë në raport me këtë? Si mund dikush ta ndihmojë që të ndihet më mirë?

Shtesa

Materiale

Shtesa nr. 1

Link i videos nga punimi



Shtesa nr. 2

Skemë me katrorë me detyrë

Fletë; ngjyra; ngjitës ose kapëse.


Aktiviteti është përgatitur nga:

Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva

Dizajn grafik: Katerina Nikolovska

Lekturë: Jana Mihajlovska

Përkthim: Agim Leka



Secilit njeri i nevojitet

